

**VENDIM I ORTAKUT TË VETËM  
TË SHOQËRISË  
AGA SOLAR SH.P.K.**

Datë: 18 maj 2023  
Vendi: Tiranë

**AGJENDA:**

1. Kufizimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë Aga Solar Sh.p.k. dhe kufizime të tjera në favor të Global Subnational Fund SCSP;
2. Të ndryshme.

**MEQËNËSE:**

- A. **Aga Solar Sh.p.k.**, është një shoqëri Shqiptare më përgjegjësi të kufizuar, themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me NUIS M11415029E ("Shoqëria").
- B. Shoqëria zotërohet nga ortaku i vetëm i cili zotëron 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë ("Kuota"), si më poshtë:
  - **Aga Solar Park Holding's Sh.p.k.**, është një shoqëri shqiptare, themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë QKB-së, me NUIS M31311044D, me adresë në Komuna Kashar – Tiranë, Zona Kadastrale 2679, Numër Pasurie 34/13/1, Godina ARDENO, KM 2, MËZEZ, Tiranë, Shqipëri ("Ortaku i Vetëm").
- C. **Global Subnational Climate Fund SCSP**, është një shoqëri speciale komandite e krijuar në përputhje me ligjin mbi shoqëritë tregtare të Luksemburgut e cila vepron me anë të Ortakut të Pakufizuar Pegasus SnCF GP S.à r.l, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjit të Luksemburgut dhe e regjistuar me nr. B249762, me seli në 106, Route d'Arlon, 8210 Mamer, Luksemburg ("SCF").
- D. SCF, Shoqëria, Ortakët dhe Ortaku i Vetëm<sup>1</sup> ("Ortakët") dhe z. Arkond Canaj kanë nënshkruar një marrëveshje kushtesh (*term sheet*) më 11 Nëntor 2022 ("Data e Nënshkrimit") në kushte të caktuara në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet Palëve për zhvillimin e Projektit dhe të Transaksionit objekt i Term Sheet ("Term Sheet").
- E. SCF dhe Ortakët kanë rënë dakord ndër të tjera për të drejtën e SCF-së për Blerje Kuotash gjatë Periudhes së Ekskluzivitetit dhe Vepprime të tjera Kufizuese në favor të SCF-së, ndërsa kjo **Periudhë Ekskluziviteti**, do të thotë sipas Term Sheet si: *periudha që fillon nga Data e Nënshkrimit deri në momentin që SCF-ja informon me shkrim Palët e tjera se nuk dëshiron të vazhdojë me Transaksionin.*
- F. Bazuar në sa më sipër, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë pranon të kufizojë shitjen e Kuotave, si dhe çdo veprim/transaksion mbi ose në lidhje me Kuotat që zotëron në kapitalin e Shoqërisë, me anë të krijimit të një të drejtë ekskluzive në favor të SCF-së, gjatë gjithë Periudhës së Ekskluzivitetit ("Kufizimi i Kuotave").
- G. Të gjitha kushtet për miratimin e një vendimi të vlefshëm janë plotësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e Shoqërisë.

<sup>1</sup>i. Genesis Projecting Sh.p.k., një shoqëri shqiptare, me NUIS L57017205G; ii. Ardeno Sh.p.k., një shoqëri shqiptare, me NUIS K11804001T; iii. Albin-Tros 2011 Sh.p.k., një shoqëri shqiptare me NUIS L13510201L; iv. Meteo Sh.p.k., një shoqëri shqiptare me NUIS L26310801C.



- H. Të gjitha fjalët me shkronja të mëdha të përkufizimeve në këtë vendim do të kenë të njëjtin kuptim siç parashikohet në Term Sheet, përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë vendim ose nëse konteksti ose përdorimi i fjalëve të tilla sugjeron ndryshe.

**BAZUAR NË SA MË SIPËR, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë VENDOSI:**

- I. **TË MIRATOJË** Kufizimin e Kuotave kundrejt Ortakut të Vetëm dhe Shoqërisë në favor të SCF-së dhe publikimin e këtij Kufizimi në Regjistrin Tregtar (QKB), që rrjedhin nga e drejta e SCF-së për të blerë Kuota si dhe në lidhje me Veprimet e tjera Kufizuese në favor të SCF-së siç parashikohet në Term Sheet, Veprime të tilla Kufizuese mbeten të vlefshme dhe në fuqi të plotë gjatë Periudhës së Ekskluzivitetit, që do të thotë nga Data e Nënshkrimit deri në momentin që SCF-ja informon me shkrim QKB-në dhe Ortakun e Vetëm, dhe/ose Ortakët e Shoqërisë se nuk dëshiron të vazhdojë me Transaksionin
- II. **TË MIRATOJË** publikimin në Regjistrin Tregtar në lidhje me Shoqërinë, si më poshtë vijon:
- i. **Kufizimi i Kuotave:** Shoqëria dhe Ortaku i Vetëm i saj kufizohen, ndalohen dhe nuk lejohen të kryejnë çdo transaksion në lidhje me Kuotat, objekt i Kufizimit të Kuotave gjatë Periudhës së Ekskluzivitetit, që do të thotë nga Data e Nënshkrimit deri në momentin që SCF-ja informon me shkrim QKB-në, Ortakët dhe Ortakut e Vetëm të Shoqërisë që nuk dëshiron të vazhdojë me Transaksionin, si dhe asnjë dhe të gjitha veprimet, duke përfshirë, por pa u kufizuar në lëshimin, abstenimin, braktisjen e çdo dhe të gjitha ofertave, kërkesave ose propozimeve për negociata, shkëmbimin e informacionit ose diskutime, etj., ose veprime ligjore ose transaksione të tjera pa asnjë kufizim, për:
- (a) tjetërsimin, shitjen, transferimin ose dhurimin e Kuotave, si dhe çdo premtim për shitje, krijimin e opsiioneve ose veprimeve të tjera mbi Kuotat në favor të palëve të treta, duke përfshirë por pa u kufizuar në krijimin e barrëve, pengjeve, kufizimet e çdo lloji mbi Kuotat e Kufizuara, zvogëlimin i kapitalit, bashkimin ose ndarjen e Shoqërisë, rikapitalizimi, riorganizimi, ndryshimi i formës së Shoqërisë, ose ndryshe, të cilat do të cenonin të drejtat e ekskluzivitetit të SCF-së sipas këtij Vendimi dhe Term Sheet, dhe/ose
- (b) tjetërsimin, shitjen, transferimin, dhurimin, ose ndryshe, të aseteve të Shoqërisë, cedimi ose transferimi i të gjitha të drejtave, ose të drejtat e qirasë mbi pasuritë e e marra me qira prej Shoqërisë nga palët e treta, duke përfshirë por pa u kufizuar në abstenim/mosveprim/ moskrijimin e të drejtave në favor të palëve të treta për të drejtat e qirasë ose përdorimin e pasurive (nënpërshtatje) nga palët e treta, në lidhje me asetat në pronësi të Shoqërisë ose të dhëna me qira nga palët e treta, persona juridikë, publikë ose privatë, ose individë;
- ii. **Veprimet Kufizuese:** Ndalimi për të kryer ndonjë veprim si vijon:
- (a) transferojë çdo aset, të drejtë, leje ose licencë të Projektit jashtë Shoqërisë;
- (b) të shesë, transferojë peng ose të bëjë diçka të ngjashme me sa më sipër në lidhje me çdo Kuotë në Shoqëri;
- (c) të bëjë ndonjë kosto, detyrim ose borxh tjetër financiar;
- (d) të japë ndonjë garanci ose krijojë barrë tjetër mbi çdo aset të Shoqërisë;
- (e) jep çdo garanci në lidhje me çdo borxh financiar të çdo personi;
- (f) të krijojë ndonjë filial; ose
- (g) të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër përveç Projektit.
- III. **TË MIRATOJË** krijimin/vendosjen e një garancie mbi Kuotat në favor dhe përfitim të SCF-së ("Garancia mbi Kuotat"), për të siguruar/garantuar:



2

- (i) të drejtat e dëmshpërblimit në rast të shkeljes së detyrimeve të Term Sheet (duke përfshirë por pa u kufizuar në çdo shkelje të mundshme të Kufizimit mbi Kuotat dhe Periudhës së Ekskluzivitetit) nga Ortakët, shuma e siguruar sipas kësaj Garancie është e barabartë me shumën 10 (dhjetë) milionë Euro si dëmet e likuiduara (kusht penal) për shkeljen e detyrimeve të Ortakëve dhe/ose të Ortakut të Vetëm sipas Term Sheet (*që për hir të qartësisë korrespondon me kushtin penal vlerësues sipas nenit 543, paragrafi 1 i Kodit Civil Shqiptar*); dhe
- (ii) detyrimet e Shoqërisë sipas marrëveshjes së huasë të datës 18 maj 2023, ndërmjet SCF si Huadhënës dhe Shoqëria si Huamarrëse për një lehtësi kredie me afat në një shumë principal deri në 550,000 USD që SCF-ja i ka vënë në dispozicion Shoqërisë, së bashku të referuara si "**Detyrimet e Siguruara**". Çdo dhe të gjitha të drejtat e dëmshpërblimit të SCF-së që rrjedhin nga ose në lidhje me Term Sheet janë të rezervuara.

- IV. TË MIRATOJË** ekzekutimin e marrëveshjes së pengut dhe barrës siguruese për krijimin dhe regjistrimin e Garancisë mbi Kuotat dhe të autorizojë Shoqerinë të regjistrojë këtë marrëveshje siguruese në Regjistrin Shqiptar të Barrëve Siguruese dhe Regjistrin Tregtar në zbatim të legjislacionit shqiptar ("**Marrëveshja e Barrës Siguruese**").
- V. TË MIRATOJË** regjistrimin e këtij Vendimi në Regjistrin Tregtar pranë QKB dhe publikimin e saj në ekstraktin tregtar të Shoqërisë, për qëllimin e njofitimit të të tretëve. Çdo transaksion apo veprim juridik me palë të treta, pa përjashtim, që bie ndesh me këtë Vendim, Kufizimin e Kuotave dhe Term Sheet është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk ka pasoja.
- VI. TË MIRATOJË** ngjarjen e mospërmbushjes, që përbëhet nga ndonjë nga ngjarjet e renditura më poshtë ("**Ngjarja e Mospërmbushjes**"), dhe në rast se të paktën një nga këto ngjarje ndodh, SCF-ja do të ketë të drejtë të zbatojë Detyrimet e Siguruara kundër Ortakut të Vetëm dhe /ose Shoqëria, si më poshtë:
- (a) Ortakët, Z. Arkond Canaj, Ortaku i Vetëm ose Shoqëria shkelin ndonjë nga Detyrimet e Siguruara, duke përfshirë por pa u kufizuar në detyrimet, përfaqësimet, garancitë, angazhimet ose ndërmarrjet ose të ngjashme sipas Term Sheet, siç mund të informojë me shkrim çdo Ortakë i SCF-së, Z. Arkond Canaj, Ortaku i Vetëm ose Shoqëria;
  - (b) çdo borxh i Ortakut të Vetëm dhe/ose Shoqërisë nëse nuk paguhet në kohën e duhur;
  - (c) çdo borxh i Ortakut të Vetëm dhe/ose Shoqërisë bëhet i papagueshëm, ose i aftë ose deklarohet i vonuar dhe i pagueshëm përpara maturimit të deklaruar të tij për shkak të një ngjarjeje mospërmbushjeje (sido që të përshkruhet);
  - (d) çdo angazhim për borxin e Ortakut të Vetëm dhe/ose Shoqërisë anulohet ose pezullohet nga një kreditor i Ortakut të Vetëm dhe/ose Shoqërisë për shkak të një ngjarjeje mospërmbushjeje (sido që të përshkruhet);
  - (e) çdo kreditor i Ortakut të Vetëm dhe/ose Shoqërisë ka të drejtë të deklarojë çdo borxh të Ortakut të Vetëm dhe/ose të Shoqërisë të detyrueshme dhe të pagueshme përpara maturimit të deklaruar të saj për shkak të një rasti mospagimi (sido që të përshkruhet);
  - (f) Ortaku i Vetëm dhe/ose Shoqëria ndalon ose pezullon pagesën e ndonjë prej borxheve të saj, ose nuk është në gjendje, ose pranon paaftësinë e tij për të paguar borxhet e saj në kohën e duhur;
  - (g) Vlera e Ortakut të Vetëm dhe/ose assetet e Shoqërisë janë më të vogla se detyrimet e saj (duke marrë parasysh detyrimet e mundshme dhe ato të ardhshme);
  - (h) shpallet një moratorium në lidhje me çdo detyrim të Ortakut të Vetëm dhe/ose të Shoqërisë;
  - (i) ndërmerret çdo veprim, procedim, procedurë ose hap për:

- i. pezullimin e pagesave, një moratorium të çdo borxhi, mbylljeje, shpërbërjeje, administrimi ose riorganizimi (duke përdorur një marrëveshje vullnetare, skemë aranzhimi ose ndryshe) të Ortakut të Vetëm dhe/ose Shoqërisë;
- ii. përbërjen, kompromisin, caktimin ose marrëveshjen me ndonjë kreditor;
- iii. emërimi i një likuiduesi, marrësi, pranuesi administrativ, administratori, menaxheri i detyrueshëm ose zyrtari tjetër i njashëm në lidhje me Ortakun e Vetëm dhe/ose Shoqërinë ose ndonjë nga asetet; ose
- iv. zbatimin e çdo sigurie mbi çdo pasuri të Ortakut të Vetëm dhe/ose Shoqëria;
- (j) Ortaku i Vetëm dhe/ose Shoqëria fillon negociatat, ose hyn në ndonjë, kompromis, caktim ose marrëveshje, me një ose më shumë nga kreditorët e tij me synimin për të riprogramuar ndonjë nga detyrimet e tij (për shkak të vështirësive financiare aktuale ose të parashikuara);
- (k) një shqetësim, sekuestrim, ekzekutim, shpronësim, sekuestrim ose një proces tjetër ligjor analogështë vënë, zbatuar ose paditur mbi ose kundër, Ortakut të Vetëm dhe/ose aseteve të Shoqërisë; dhe
- (l) çdo ngjarje ndodh në lidhje me Ortakun e Vetëm dhe/ose Shoqërinë e njashme me ato në paragrafin (a) deri në paragrafin (j) më lart (përfshirës) sipas ligjeve të çdo juridiksi të zbatueshëm.

VII. **TË AUTORIZOJË** administratorin e Shoqërisë, ose ndonje nga avokatët e studios ligjore shqiptare Tashko Pustina Sh.p.k. regjistruar në QKB me NUIS L11806021V dhe duke vepruar si këshilltar ligjor vendor i SCF-së në lidhje me Projektin dhe Transaksionin (sic përcaktohet në Term Sheet), për të hartuar dhe nënshkruar çdo dokument, kërkesë, aplikim të nevojshëm në këtë kontekst dhe të dorëzojë të gjitha dokumentet e kërkua të përfshirës (përfshirës) sipas ligjeve të çdo juridiksi të zbatueshëm.

Asnjë vendim tjetër nuk u miratua në këtë mbledhje të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

#### ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Aga Solar Park Holding's Sh.p.k.

Ardit Alia  
Administrator



## AGA SOLAR PARK HOLDING'S SH.P.K.

VENDIM I ORTAKËVE TË SHOQËRISË  
“AGA SOLAR PARK HOLDING'S” SH.P.K.  
NUIS M31311044DD

Datë: 15/05/2023

### MEQËNËSE:

Aga Solar Park Holding's Sh.p.k. është një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit (“QKB”) me NUIS M31311044D (“Shoqëria”) zotëruese 100% e kapitalit themeltar të shoqërive si vijon:

- Aga Solar Sh.p.k.**, shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë QKB-së me NUIS M11415029E (“Aga Solar”); dhe
- Aga Solar 2 Sh.p.k.**, shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë QKB-së me NUIS M31317050I (“Aga Solar 2”),

Në selinë e Shoqërisë, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë me pjesëmarrjen e ortakëve të saj si me poshte:

- Ortaku me 30% të kuotave, shoqëria “Genesis Projecting Sh.p.k.”**, regjistruar me NUIS L57017205G pranë QKB-së, me adresë në Rrugë Sheh Ahmet Pazari 3, Zona Kadastrale 8160, Nr. Pasurie 6/371-N6, Tiranë, përfaqësuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë dhe **Administratori Z. Arkond Canaj**, atësia Irfan i ditëlindjes 19.06.1989, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës/kartës së identitetit me nr. Personal I19619097T;
- Ortaku me 30% të kuotave, shoqëria “Ardeno Sh.p.k.”** regjistruar me NUIS K11804001T, pranë QKB-së, me adresë në Mëzez, Tiranë, përfaqësuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë dhe **Administratori Z. Tonin Alia**, atësia Ded, i ditëlindjes 20.07.1955, lindur në Kryezi dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës / kartës së identitetit me nr. F50720157V;
- Ortaku me 30% të kuotave, shoqëria “Albin-Tros 2011 Sh.p.k.”** regjistruar me NUIS L13510201L pranë QKB-së, me adresë në Lagjja 5 Maj, zona kadastrale 8525, pasuria nr. A, indeksi EL L-9, Elbasan, përfaqësuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë dhe **Administratori Z. Ilmi Pupuleku**, atësia Haki, i ditëlindjes 08.01.1965 lindur në Trebisht Celebi dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës / kartës së identitetit me nr. G50108010P; dhe
- Ortaku me 10% të kuotave, shoqëria “Meteo Sh.p.k.”** regjistruar me NUIS L26310801C pranë QKB-së, me adresë në Fshati Cekin, Rrugë Nacionale Gramsh-Elbasan, ndërtësë private, zona kadastrale Nr. 1362, nr. Pasurie 6/76, pranë uzinës, Elbasan, përfaqësuar nga administratori Z. Erind Bengu.

### Me këtë rend dite:

- Miratimi i kufizimit dhe pengut dhe barrës siguruese mbi kapitalin themeltar të shoqërive Aga Solar dhe Aga Solar 2 në favor të shoqërisë Global Subnational Climate Fund SCSP (“Huadhënësi” ose “Barrëmarrësi”);
- Miratimin e marrëveshjes së huasë me Huadhënësin nga Aga Solar (“Marrëveshja e Huasë”) dhe autorizimin e administratorit të Aga Solar të nënshkruajë Marrëveshjen e Huasë.
- Autorizimi i administratorit të Shoqërisë, Z. Ardit Alia që të përfaqësojë Shoqërinë, të firmosë në emer të Shoqërisë marrëveshjen e barrës siguruese dhe pengut si edhe vendimet përkatëse të Aga Solar dhe Aga Solar 2 në lidhje me kufizimin, pengun dhe barrën siguruese sipas pikës 1 këtu më sipër dhe kryerjen e veprimeve të tjera në lidhje me to;

## AGA SOLAR PARK HOLDING'S SH.P.K.

### 4. Të tjera.

**Bazuar sa më sipër, ortakët e Shoqërisë vendosën UNANIMISHT:**


- I. **Miratimin** e kufizimit të kuotave të shoqërive Aga Solar dhe Aga Solar 2 të zotëruara nga Shoqëria në favor të Global Subnational Climate Fund SCSP.
- II. **Miratimin** e Marrëveshjes së Huasë dhe autorizimin e administratorit të Aga Solar të nënshkruajë Marrëveshjen e Huasë, këtu bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. **Miratimin** e vendosjes së pengut dhe barrës siguruese mbi kuotat e Aga Solar dhe Aga Solar 2 të zotëruara nga Shoqëria në favor të Barrëmarrësit si dhe regjistrimin e barrës siguruese pranë Regjistrat të Barrëve Siguruese dhe Regjistrat Tregtar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- IV. **Miratimin** e regjistrimit të këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe publikimin e tij në ekstraktin historik të Shoqërisë.
- V. **Miratimin** e administratorit të Shoqërisë, Z. Ardit Alia që të përfaqësojë Shoqërinë, të firmosë në emer të Shoqërisë marrëveshjen e barrës siguruese dhe pengut si edhe vendimet përkatëse, si përfaqësues i Shoqërisë në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Aga Solar dhe Aga Solar 2 në lidhje me pengun dhe barrën siguruese mbi kapitalin themeltar të shoqërive Aga Solar dhe Aga Solar 2, sipas pikës I dhe II këtu më sipër, si dhe të depozitojë pranë QKB-së dhe të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi.

Asnjë vendim tjetër nuk u miratua në këtë mbledhje të Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

Ortakët e Shoqërisë  
Aga Solar Park Holding's Sh.p.k.

Për Genesis Projecting Sh.p.k.

Znj. Malvina Shllaku


  
Administrator

Konfirmon ortaku i vetëm: Arkond Canaj




Për Albin-Tros 2011 Sh.p.k.

Z. Ilmi Pupuleku



Për Ardeno Sh.p.k.


Z. Tonin Alia

  
Administrator



Për Meteo Sh.p.k.

Z. Erind Bengu

  
Administrator

Konfirmon ortaku i Vetëm: Era Myftari

